

**Prezantimi i Raportit të veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2016 në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave – Kuvendi Shqipërisë**

**Prof.Dr. Juliana Latifi – Kryetare e Autoritetit të Konkurrencës**

Tiranë, më 03.04.2016

Përshëndetje të gjithëve !

Do të bëj një paraqitje të shkurtër të aktivitetit të Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2016.

Nëse Komisioni dëshiron të dhëna më të detajuara në shifra dhe fakte të veprimtarisë së AK për vitin 2016, Sekretarja e Përgjithshme e Autoritetit të Konkurrencës, si dhe anëtarët e Komisionit të Konkurrencës mund të japin një informacion më konkretisht.

Viti që lamë pas, në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit u shoqërua me një veprimtari aktive të Autoritetit të Konkurrencës, ku drejtimet kryesore të tij janë:

- I. Monitorimi, hetimi dhe dhënia e rekomandimeve përkatëse në tregje kryesore dhe sensitive të ekonomisë shqiptare, me impakt të drejtpërdrejtë te konsumatori shqiptar, përkatësisht:**

Monitorimi u realizuar në këto tregje:

1. Tregu i mediave audiovizive;
2. Tregu i shërbimit të certifikim- inspektimit të transportit të karburanteve dhe lëndëve të rrezikshme;
3. Tregu i prokurimit publik ne fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit;
4. Tregu i karburanteve;
5. Tregu farmaceutik;

Hetimi u realizua në këto tregje:

1. Tregu farmaceutik me objekt - *produktin farmaceutik “Insulinë”;*
2. Tregu duhanit me objekt - *prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe eksportin e duhanit;*
3. Tregu i karburanteve në zonë gjeografike të “Aeroporti Ndërkombëtar të Rinasit”;
4. Tregu prokurimeve publike me objekt - *shërbimi i rojeve private;*

5. Tregu i agrobiznesit me objekt - *qumështi dhe nënproduktet e tij*;
6. Tregu sigurimeve me objekt - *sigurimi i detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta*;
7. Tregu bankar.

Monitorimi dhe hetimi u shoqërua edhe me bashkëpunimin e Autoritetit të Konkurrencës me autoritetet e tjera rregullatore dhe dhënien e rekomandimeve përkatëse, veçanërisht:

1. Në tregun e prokurimit publik;
  2. Në tregun e qirasë financiare;
  3. Në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik;
  4. Në tregun bankar.
  5. Të tregun e agrobiznesit.
- II. Veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës u fokusua edhe në **dhënien e vlerësimeve ligjore të akteve normative të institucione shtetërore dhe publike**, akte të cilat kanë si objekt ose pasojë dhënien e të drejtave ekskluzive ose vendosjen e kufizime sasiore apo cilësore të konkurrencës në treg, ose sektorë të ndryshëm të ekonomisë, përkatësisht:
1. Koncesionin e partneritetit publik-privat të formës ROT, për infrastrukturën hekurudhore Fier-Ballsh, Fier-Vlorë.
  2. Marrëveshja e Koncesionit “Për dhënien me Koncesion të shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre, në Republikën e Shqipërisë”.

Nga ana tjetër Autoriteti Konkurrencës bëri **vlerësimin ligjor edhe për një sërë aktesh të tjera ligjore**, ku mund të përmendim:

1. Kodin Hekurudhor të Republikës së Shqipërisë;
  2. Modelin e tregut të energjisë elektrike; diktuar nga kuadri i ri ligjor në këtë fushë;
  3. Udhëzimin mbi rregullat në vendosjen e tarifave të aeroportit.
- III. Gjatë vitit 2016, **u vu re një rritje e numrit të njoftimeve të përqendrimeve pranë Autoritetit të Konkurrencës**, diktuar kjo nga dinamika që shfaq tregu i brendshëm si dhe të transaksioneve mes kompanive të huaja, të cilat me xhiron e tyre të fitimit ndikojnë në tregun e shqiptar dhe, për pasojë klasifikohen si transaksione të cilat duhet të njoftohen pranë AK-së.

Përqendrimet e autorizuara për vitin 2016 përfshimë këto tregje:

1. Tregu financiar - 4
2. Tregu i ndërtimeve - 3
3. Infrastruktura e transportit ajror - 2
4. Tregu i lotarive - 1
5. Tregu i hidrokarbureve - 1

IV. Objekt i veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës ishte edhe **“Përjashtimi nga ndalimi i marrëveshjeve”**, për ato marrëveshje të cilat në parim nxisin progresin teknologjik apo ekonomik:

1. Marrëveshja Tip midis “Digitalb - Operatorë Televizivë”.
2. Marrëveshja OSHEE-KESH për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha me qëllim plotësimin e humbjeve të sistemit të shpërndarjes për vitin 2015.

V. Gjatë vitit 2016, po ashtu kemi edhe **raportin e Autoritetit të Konkurrencës me Gjykatat - 52 vendime u dhanë nga Komisioni i Konkurrencës për 2016**, kundrejt të cilave u **ushtrua e drejta ankimit për vetëm 1 (një) vendim**.

Krahas vendimit të ankimit për herë të parë gjatë vitit 2016, veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës në raport me procesin gjyqësor, ka vazhduar edhe kundrejt atyre çështjeve, të cilat janë duke u gjykuar në Gjykatën Administrativë të Apelit, si dhe në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Gjithashtu, Autoriteti i Konkurrencës në funksion të zbatimit të ligjit dhe të **përafrimit të tij me acquis të BE-së** plotësojë edhe kuadrin nënligjor të tij nëpërmjet miratimit të dy akteve:

1. Rregullorja “Mbi procedurat e angazhimeve”, me objekt përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që duhet të zbatohen nëpërmjet vendimeve me angazhime nga ndërmarrjet, vendime të cilat kthehen në angazhime ligjore, duke mos patur nevojë për hetime të mëtejshme nga ana e AK-së.
2. Udhëzimi “Për procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendrimeve”, i cili bazuar në natyrën e përqendrimit, nuk kërkon analiza të detajuara, lehtëson ndërmarrjet nga sigurimi i informacioneve të thelluara, dhe Komisioni i Konkurrencës autorizon përqendrimin, pa kryer hetime të mëtejshme dhe analiza të mirëfillta ekonomike.

Për sa më sipër, kjo përbën një pasqyrë të përmbledhur të veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2016.

Nga një këndvështrim institucional fundi i vitit 2016 përkon me zgjedhjen time nga ana e Kuvendit si Kryetare e re e Autoritetit të Konkurrencës pas përfundimit të mandatit të kryetares së mëparshëm.

Për këtë qëllim në axhendën e veprimtarisë së Autoritetit për vitin 2017, janë përfshirë një sërë objektivash institucionale të cilat përveç përmirësimit të qeverisjes së Autoritetit do të mundësojnë dhe forcimin e rolit të Autoritetit në kapacitetin e tij analizues, këshillues por edhe pse jo penalizues.

Këtu doja të theksoja ato që konsiderohen objektiva kryesore institucionale të AK :

- I. **Rishikimi i kuadrit ligjor**, dhe veçanërisht ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës , rishikim i cili synon :
  1. Rritjen e rolit të anëtarëve - komisionerëve të Komisionit të Konkurrencës, nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre si relatorë për çdo çështje e cila hetohet nga Sekretariati i Konkurrencës, edhe për vetë natyrën që ka ky Komision si një *quasi* gjykatë.
  2. Një përcaktim dhe rregullim sa më të saktë dhe të plotë, të tre shtyllave kryesore të konkurrencës: marrëveshjeve të ndaluara; pozitës dominuese; dhe përqëndrimeve, nisur kjo nga praktikat më të mira europiane, por edhe nga problematikat që ka dalë gjatë zbatimit të ligjit në vite.
- II. **Riorganizimin e strukturës organizative** të Autoritetit të Konkurrencës, diktuar nga dinamika dhe larmia e tregjeve sot, si dhe nga nevoja për ta bërë atë një strukturë fleksibël në proceset e monitorimit, inspektimit, dhe vendimmarrjes.

Krahas këtyre dy objektivave kryesore institucionale, do të doja të theksoja se gjatë viti 2017 veprimtaria e **Autoritetit do të fokusohet edhe në drejtim të përcaktimit sa më të qartë të rregullave të sjelljes së ndërmarrjeve** në të gjitha tregjet **dhe veçanërisht, në tregje sensitive:** energjia, gazi dhe karburantet, shërbimet financiare, komunikimet elektronike dhe transporti, duke ndërhyrë rast pas rasti, për të rivendosur konkurrencën e lirë dhe efektive në treg.

Po ashtu, **Autoriteti i Konkurrencës**, edhe gjatë vitit 2017 mbetet tërësisht i angazhuar **për të përdorur instrumente dhe të gjitha burimet në dispozicion: administrative, financiare dhe**

**intelektuale** për të luftuar monopolet dhe kartelet dhe për t'i dhënë frymëmarrjen e duhur biznesit të ndershëm dhe zhvillimit ekonomik të vendit.

Autoriteti i Konkurrencës synon, që gjatë vitit 2017 të risi rolin e tij, duke **bashkëpunuar me institucionet shtetërore dhe ato publike**, në fushën e vlerësimeve ligjore paraprake të akteve normative, **të cilat vendosin të drejta ekskluzive ose të drejta të veçanta**.

*Së fundmi:* Në emër të Autoritetit të Konkurrencës **dëshiroj të garantoj Kuvendin e Shqipërisë** se veprimtaria e tij do të jetë në frymën e ligjit dhe në koherencë të plotë me objektivat kombëtare për zhvillimin ekonomik-financiar të qëndrueshëm të vendit dhe përafrimin e pandërprerë me Bashkimin Europian.